



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.4.2023

Nr: 264

Ora: 19:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK,
BASHKIA ELBASAN, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA ORA E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 4.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Ora e Shqipërisë" me shkronja nistore "P.O.SH"

OBJEKTI: Miratimi i listwv shumemërore të subjektit zgjedhor "Partia Ora e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data:4.4.2023 Nr: 264
Ora: 19:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Elbasan, të subjektit zgjedhor "Partia Ora e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Me vendimin nr. 108, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Partia Ora e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbështetje të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur, dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listave shumemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit elektronik. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak për bashkinë Elbasan të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë” sipas së cilës rezulton se:

1. Kandidatët e propozuar në listën shumemërore nga “Partia Ora e Shqipërisë” për këshillin bashkiak **Elbasan** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 pasi rezultojnë të jenë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”. Referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e

integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrajnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë” nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumëmemërore të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në Bashkinë Elbasan, të subjektit zgjedhor “Partia Ora e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Partia Ora e Shqipërisë**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Hasan	Sali	Bardho	22/05/1962	M
2	Violeta	Zylyf	Shkalla	30/07/1974	F
3	Sefer	Hasan	Bardho	08/10/1981	M
4	Matilda	Bajram	Bardho	19/11/1993	F
5	Mariel	Bajram	Duraku	24/08/1997	M
6	Fatmire	Ismail	Duraku	15/08/1971	F
7	Bajram	Rrapush	Duraku	15/05/1967	M
8	Drita	Qazim	Duraku	11/01/1973	F
9	Shkëlqim	Xhemal	Kapo	02/08/1966	M
10	Elsa	Jorgji	Shqau	12/04/1990	F
11	Xhemal	Shkëlqim	Kapo	21/02/1998	M
12	Lule	Hamza	Kapo	18/01/1969	F
13	Edmond	Hasan	Bardho	15/10/1982	M
14	Daniela	Shkëlqim	Kapo	03/06/1993	F
15	Leorenc	Hasan	Bardho	25/05/1986	M
16	Gure	Hysen	Bardho	10/07/1983	F
17	Selman	Resul	Senja	27/10/1953	M
18	Zalide	Demir	Senja	25/01/1961	F
19	Vladimir	Selman	Senja	02/04/1979	M
20	Merita	Faik	Senja	20/07/1987	F
21	Valentino	Vladimir	Senja	14/02/1997	M
22	Floresha	Qemal	Senja	25/06/1977	F
23	Leonidha	Selman	Senja	23/12/1984	M
24	Sonata	Hamit	Beqiri	05/11/1994	F
25	Lavdi	Seit	Beqiri	08/05/1986	M
26	Drita	Jonuz	Beqiri	17/03/1988	F
27	Seit	Xhaferr	Beqiri	24/09/1959	M
28	Nurije	Selim	Beqiri	12/10/1962	F
29	Ajet	Seit	Beqiri	23/02/1990	M
30	Mirjeta	Mexhit	Haka	02/08/1971	F
31	Fadil	Ali	Haka	24/05/1942	M
32	Shkelqim	Fadil	Haka	01/08/1969	M
33	Bujare	Astrit	Zharri	26/10/1996	F
34	Leandro	Lulzim	Shkalla	17/09/2004	M
35	Elsa	Kujtim	Dervishi	19/10/1989	F
36	Elton	Hasan	Tola	31/10/1989	M



Partia Ora e Shqipërisë**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Vjollca	Hamza	Bardho	02/10/1960	F
38	Agim	Ramazan	Bullari	25/07/1972	M
39	Mirela	Hasan	Bardho	08/05/1984	F
40	Shpetim	Vladimir	Kapo	09/03/1990	M
41	Merita	Vait	Pecaku	06/11/1969	F
42	Fatbardh	Sadik	Ruçi	11/12/1984	M
43	Lindita	Refat	Zeneli	18/02/1969	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

43